



Marrja e tabletave të jodit

(Tableta jodur kaliumi G.L. Pharma 65 mg)

Në rast aksidenti rrezatimi, tabletat e jodit përdoren për të parandaluar grumbullimin e jodit radioaktiv (izotopet radioaktive të jodit) të lëshuara në ajër në gjëndrën tiroide pas gëlltitjes ose thithjes. Përdorimi i tabletave të jodit në rast të rrezikut nga rrezatimi zvogëlon rrezikun e kancerit të tiroides.

Merrni jod vetëm kur autoritetet lëshojnë një njoftim për marrjen e ilaçit. Autorizimi për marrjen e barit do të shpallet në radio ose televizion ose përmes komunikimeve të tjera zyrtare.

Ilaçet nuk duhet të merren si masë paraprake

Paketa përmban 10 tableta. Mos e tejkaloni dozën. Merrni vetëm një dozë. Autoritetet mund t'ju këshillojnë të merrni një dozë të dytë më vonë. Megjithatë, një dozë e dytë nuk rekomandohet për foshnjat e porsalindura, gratë shtatzëna ose nënat që ushqehen me gji.

Dozimi i tabletave të jodit për grupmosha të ndryshme dhe gra shtatzëna

(zbatohet vetëm për tabletat 65 mg)

Mosha	Doza	Numri i tabletave 65 mg	Imazhi
foshnja nën 1 muaj	16,25 mg	$\frac{1}{4}$ tabletë	
1 muajsh–2 vjeç	32,5 mg	$\frac{1}{2}$ tabletë	
fëmijët e moshës 3–11 vjeç	65 mg	1 tabletë	
personat e moshës 12–40 vjeç dhe gratë shtatzëna	130 mg	2 tableta	

Personat mbi 40 vjeç nuk përfitojnë nga jodi (përfashtuar gratë shtatzëna).

Tableta e jodit gjithashtu mund të shtypet ose të përthypet. Për ta bërë më të lehtë marrjen e ilaçit, mund ta shtypni tabletën e jodit, për shembull, me një lugë dhe ta shpërndani në një sasi të vogël uji, qumështi ose lëngu. Mund të duhen disa minuta që ilaçi të shpërndahet.

Mos merrni tableta jodi nëse:

- tiroidja juaj është hequr ose nuk funksionon (jodi nuk është i dobishëm)
- ju keni pasur më parë një reaksion serioz alergjik ndaj jodit
- ju vuani nga hipertiroidizmi, dermatiti herpetiformis ose vaskuliti me nivele të reduktuara të komplementit (vaskuliti hipokomplementemik).

Mbani tabletat jashtë mundësive të fëmijëve. Nëse fëmija juaj ka dy shtëpi, mbajini tabletat në të dyja shtëpitë.

